



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 664 Prot.

Tiranë, më datë 27.04 2023

VENDIM  
Nr. 222, datë 27.04.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 27.04.2023:

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin “Riparim çatie me porositës Z. Hysenj Hetem Kovaçi”, brenda kufirit Zonë e Mbrojtur e Qendrës Historike, Gjirokastër, me Nr. Pasurie 13/178+1-6, Zona Kadastrale 8542, me vendndodhje Dunavat, Bashkia Gjirokastër, me aplikues dhe zhvillues **Hysenj Kovaçi** dhe plotësimin e aplikimit me pikat e mëposhtme:
  - Zërat e preventivit të jenë në përputhje me manualin e çmimeve;
  - Të depozitohen analizat e zërave të cituara në preventiv;
  - Të paraqitet kartela e pasurisë së rifreskuar dhe harta treguese e pasurisë;
  - Të identifikohet grafikisht sipërfaqja takuese sipas çertifikatës së pronës në planimetrinë e objektit duke saktësuar pjesën, në të cilën parashikohet ndërhyrja/rikonstrukcioni i çatisë;
  - Projekti të jetë i qartë dhe në përputhje me sipërfaqen sipas çertifikatës së pronësisë;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
3. Ndaj vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Klesta QIRICI

